

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA PËR KËRKPONJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. DPK/DMP	Nr. Prot. Br. Prot. 03-3072/13 Prot. No.
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages 02	Data Datum Date 27-09-2013
PRISHTINE	

Regi.nr.8004/12-3

Gjykata Themelore Prishtinë-Dega Podujevë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i Kundërvajtjes,gjyqtari i kundërvajtjes duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit:**Ismet Uka nga Podujeva**,për kundërvajtje nga neni 17 paragrafit 1.3 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, e në mbështetje të neneve 73,74, 195 dhe 199 e Ligjit mbi kundërvajtjet (Gaz.Zyr.e Kosovës nr.23/79)me dt.04.09.2013,merr:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Ismet Bajram Uka i lindur më 05.07.1961 në Dumnicë të Poshtme ,jeton në Podujevë,Rr."Skenderbeu", me profesion Auditor i mbrendshëm në KK Podujevë.

ESHTË PËRGJEGJËS

Sepse në afatin prej 01.Mars deri me dt.31 Mars të vitit 2012 , nuk e ka përmbush obligimin ligjor që parashihet me ligjin për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë.

Me këtë veprim i pandehuri kreu kundërvajtje nga neni 17 paragrafit 1.3 të Ligjit për Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë , e në bazë të nenit 9 par.1 pika 1 të LMK,shpallet përgjegjës dhe

NDËSHKOHET

Me denim me gjobë **450€** (katërqindë e pesëdhjetë euro) të cilin ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh,nga dita kur ky aktvendim e merr formen e prerë.Në rast se i pandehuri denimin e shqiptuar nuk e paguan në afatin e përcaktuar, i njejti do t'i zavendësohet me denim me burg në kohëzgjatje prej **30 ditësh** duke llogaritur nga **15€** për një ditë burgimi.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet e procedurës kundërvajtëse në shumë prej si dhe shumë e shpenzimeve paushalle në favor të kësaj Gjykate prej **5 €** (pesë euro) në afat prej 15 ditësh,nga dita kur ky aktvendim e merr formen e prerë,nën kërcnimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Nga një kopje të këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkeses për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Arsyetim

Agjencia Kundër Korrupsionit-Prishtinë,parashtrroi kërkesen për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr.01-2535/12 me dt.13.07.2012, kundër të pandehurit për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pasi iu komunikua fajsia të pandehurit në mbrojtjene tij deklaroi:Është e vërtetë se nga dt.01 Mars deri më 31 Mars të vitit 2012 në këtë afat ligjor për deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik nuk e kam bërë ndonëse nuk kam qenë i njoftuar dhe nuk kam ditur se në këtë afat duhet të bëjë deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik,për vendin e punës ku punoj si auditor i mbrendshëm,kurse me dt.13.08.2012,çka ua shtri në shiqim vërtetimin nr.03/3607/12 te Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë kam dorëzuar formularin për deklarimin e prejardhjes dhe gjendjes së pasurisë

3072/13/02
fery


Pas zbatimit të procedurës së provave, marrjes në pyetje të të pandehurit, dhe administrimit të roveve relevante, Gjyqtari i kundërvajtjes, konstatoi se i pandehuri e kreu kundërvajtjen që i vihet në barrë së këndejmi i njëjti për këtë veprim inkriminues u shpall përgjegjës dhe u ndëshkua me këtë lloj dhe artësi të dënimit, duke menduar se dënimi i shqiptuar do të arrij efektin e ndëshkimit, për çka u aplikua neni 9 par.1 pika 1 të LMK që ka të bëjë me zbutjen e dënimit nën masën minimale të dënimit që është përcaktuar për atë kundërvajtje.

Me rastin e matjes së dënimit dhe ngarkimin me obligimin për pagimin e shpenzimeve u muarën parasysh rrethanat relevante lehtësuese dhe rënduese, me ndikimin për rastin e inkriminuar kundërvajtjes.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e paknaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm-Divizioni i Kundërvajtjes nëpërmes të kësaj Gjykate pa taksë.

U VENDOS NË GJYKATËN THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI KUNDËRVAJTJES



GJYQTARI,
Xhevat Begolli